

# Produkti i Brendshëm Bruto, 2013

## \*Vlerësim paraprak

**Tiranë, më 16 Dhjetor 2014:** INSTAT paraqet për përdoruesit të dhënat vjetore paraprake të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) për vitin 2013. Sipas të dhënave me bazë vjetore, PBB me çmime korente në vitin 2013 u vlerësua 1.364.782 milionë lekë (9.730 milionë Euro) ndaj 1.335.488 milionë lekë që ishte në vitin 2012. Në vitin 2013, PBB në terma nominalë (në vlerë) u rrit me +2,19 %.

Në vitin 2013 ekonomia shqiptare shënoi një rritje në terma real (në volum) prej +1,39 % krahasuar me vitin 2012. Deflatori i PBB-së për vitin 2013 ishte +0,79 %. Mbështetur mbi këto rezultate, PBB për frymë në vitin 2013 arriti në 471 mijë lekë (ose 3.358 €) nga 460 mijë lekë (ose 3.312 €) që ishte në vitin 2012.

Sipas *PBB-së me metodën e prodhimit*, rritjet në terma real për degët kryesore të ekonomisë në vitin 2013, janë: *Bujqësia, gjuetia, pyjet dhe peshkimi* me +0,61 %, *Industria* me +7,90 %, *Ndërtimi* +1,13 % dhe *Shërbimet* me +0,08 %. Në degët përbërëse të shërbimeve, *Transporti* dhe *Post-komunikacioni* paraqiten me rënie, përkatësisht me -8,05 % dhe -8,03 %, ndërsa degët *Tregti, Hotele dhe restorante* dhe *Shërbimet e tjera* shënojnë rritje prej +0,62 % dhe +1,67 %.

Peshën më të madhe në ekonomi për vitin 2013 vazhdojnë ta zënë *Shërbimet* gjithsej me 43,8 % të PBB, pasuar nga *Industria dhe Ndërtimi* 23,6 % dhe *Bujqësia, gjuetia, pyjet dhe peshkimi* me 19,64 %.

Sipas *PBB-së me metodën e shpenzimeve*, *Konsumi final* përbën peshën kryesore të shpenzimeve në ekonomi, me 89,34 %. Ky komponent u rrit me +1,94 % në terma real. Në vitin 2013, *Formimi bruto i kapitalit fiks* përbën 25,9 % të PBB-së dhe u rrit me +1,16 % në terma real krahasuar me vitin 2012. *Eksporti i mallrave dhe shërbimeve* u rrit në terma real me +7,89 % krahasuar me vitin 2012, ndërkohë që *Importet e mallrave dhe shërbimeve* u rriten me një ritëm më të ulët, me +4,99 %.

**Për publikim 16/12/2014**


**Tab.1 Treguesit kryesorë makroekonomikë (2012-2013 me çmime korente)**

Treguesit		Vitet	
		2012*	2013**
Produkti i Brendshëm Bruto me çmime korente (në milion lekë)		1.335.488	1.364.782
Të ardhurat kombëtare bruto (në milion lekë)		1.325.561	1.367.742
Rritja reale vjetore e PBB me çmime konstante krahasuar me vitin e mëparshëm (në %)		1,62	1,39
Deflatori i PBB (në %)		1,04	0,79
Popullsia mesatare vjetore (në mijë banorë)		2.900,489	2.897,366
Produkti i Brendshëm Bruto për frymë	Mijë lekë	460	471
	EURO	3.312	3.358
	USD	4.257	4.458

2012\* Të dhëna gjysëm-finale

2013\*\* Të dhëna paraprake

**Fig 1. PBB dhe rritja ekonomike, 2009-2013**



Tab.2 Indekset e rritjes në vlerë dhe struktura e PBB me çmimet e tregut, 2012-2013

Kodi	Aktiviteti ekonomik sipas NVE Rev. 1.1	Vlerat me çmime korente Në Milion Lekë		Indeksi i rritjes nominale (%) (2013/2012)	Struktura e PBB (%)	
		2012*	2013**		2012*	2013**
A1	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	250.767	266.121	6,12	18,78	19,50
A2	Peshkimi	1.843	1.972	7,03	0,14	0,14
A3	Nxjerrja e mineraleve energjitike	50.112	56.131	12,01	3,75	4,11
A4	Nxjerrja e mineraleve jo energjitike	15.070	15.906	5,55	1,13	1,17
A5	Industria e përpunimit të drithërave	4.140	3.650	-11,83	0,31	0,27
A6	Industri të tjera të produkteve ushqimore	8.772	8.453	-3,64	0,66	0,62
A7	Industria e tekstileve dhe lëkurës	19.179	20.660	7,72	1,44	1,51
A8	Industria e drurit, letrës, mobiljeve dhe publikimit	14.864	13.672	-8,02	1,11	1,00
A9	Industria e rafinimit të naftës dhe koksifikimit	2.653	1.033	-61,05	0,20	0,08
A10	Industria kimike dhe e kauçikut	3.654	3.842	5,14	0,27	0,28
A11	Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë jo metalikë	11.369	11.310	-0,52	0,85	0,83
A12	Metallurgjia dhe përpunimi i metaleve	12.139	11.490	-5,35	0,91	0,84
A13	Fabrikimi i makinerive dhe pajisjeve	1.635	1.669	2,13	0,12	0,12
A14	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike dhe gazit	19.161	26.690	39,30	1,43	1,96
A15	Prodhimi dhe furnizimi me ujë	4.207	4.545	8,04	0,31	0,33
A16	Ndërtimi	140.651	143.410	1,96	10,53	10,51
A17	Tregtia	151.430	155.607	2,76	11,34	11,40
A18	Hotele dhe restorante	23.754	23.778	0,10	1,78	1,74
A19	Transporti	43.987	40.486	-7,96	3,29	2,97
A20	Posta dhe komunikacioni	34.693	32.035	-7,66	2,60	2,35
A21	Aktivitete financiare	32.133	30.359	-5,52	2,41	2,22
A22	Aktivitete mbi pasuritë e patundshme, dhënies me qera dhe shërbime për ndërmarrjet	127.255	129.622	1,86	9,53	9,50
A23	Administrata publike dhe e mbrojtjes	52.360	52.779	0,80	3,92	3,87
A24	Arsimi	56.844	57.309	0,82	4,26	4,20
A25	Shëndeti	33.887	36.829	8,68	2,54	2,70
A26	Shërbime të tjera kolektive, sociale dhe personale	40.819	39.177	-4,02	3,06	2,87
	<b>Vlera e Shtuar Bruto me çmime bazë</b>	<b>1.157.377</b>	<b>1.188.536</b>	<b>2,69</b>	<b>86,66</b>	<b>87,09</b>
	Taksa neto mbi produktet	179.606	179.092	-0,29	13,45	13,12
	Subvencionet mbi produkte	-1.494	-2.847	90,53	-0,11	-0,21
	<b>PBB ME ÇMIMET E TREGUT</b>	<b>1.335.488</b>	<b>1.364.782</b>	<b>2,19</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>

2012\* Të dhëna gjysëm-finale

2013\*\* Të dhëna paraprake

Tab.3 PBB me çmimet korente, të vitit të mëparshëm dhe rritja reale vjetore, 2012-2013

Kodi	Treguesit	Vlerat me çmime korente Në Milion Lekë		Vlerat me çmime të vitit të mëparshëm	Rritja reale (%)
		2012*	2013**	2013**	2013**
A1	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	250.767	266.121	252.138	0,55
A2	Peshkimi	1.843	1.972	2.002	8,66
A3	Nxjerrja e mineraleve energjitike	50.112	56.131	57.103	13,95
A4	Nxjerrja e mineraleve jo energjitike	15.070	15.906	15.926	5,68
A5	Industria e përpunimit të drithërave	4.140	3.650	3.501	-15,44
A6	Industri të tjera të produkteve ushqimore	8.772	8.453	8.461	-3,55
A7	Industria e tekstileve dhe lëkurës	19.179	20.660	20.331	6,01
A8	Industria e drurit, letrës, mobiljeve dhe publikimit	14.864	13.672	13.598	-8,52
A9	Industria e rafinimit të naftës dhe koksifikimit	2.653	1.033	1.070	-59,68
A10	Industria kimike dhe e kauçukut	3.654	3.842	3.801	4,03
A11	Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë jo metalikë	11.369	11.310	11.379	0,08
A12	Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve	12.139	11.490	11.775	-3,00
A13	Fabrikimi i makinerive dhe pajisjeve	1.635	1.669	1.596	-2,35
A14	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike dhe gazit	19.161	26.690	27.165	41,77
A15	Prodhimi dhe furnizimi me ujë	4.207	4.545	4.446	5,69
A16	Ndërtimi	140.651	143.410	142.236	1,13
A17	Tregtia	151.430	155.607	152.948	1,00
A18	Hotele dhe restorante	23.754	23.778	23.320	-1,83
A19	Transporti	43.987	40.486	40.444	-8,05
A20	Posta dhe komunikacioni	34.693	32.035	31.906	-8,03
A21	Aktivite financiare	32.133	30.359	32.676	1,69
A22	Aktivite mbi pasuritë e patundshme, dhënies me qera dhe shërbime për ndërmarrjet	127.255	129.622	129.149	1,49
A23	Administrata publike dhe e mbrojtjes	52.360	52.779	53.876	2,90
A24	Arsimi	56.844	57.309	57.653	1,42
A25	Shëndeti	33.887	36.829	37.187	9,74
A26	Shërbime të tjera kolektive, sociale dhe personale	40.819	39.177	38.482	-5,73
<b>Vlera e Shtuar Bruto me çmime bazë</b>		<b>1.157.377</b>	<b>1.188.536</b>	<b>1.174.170</b>	<b>1,45</b>
Taksa neto mbi produktet		179.606	179.092	182.728	1,74
Subvencionet mbi produkte		-1.494	-2.847	-2.811	88,11
<b>PBB ME ÇMIMET E TREGUT</b>		<b>1.335.488</b>	<b>1.364.782</b>	<b>1.354.087</b>	<b>1,39</b>

2012\* Të dhëna gjysëm-finale

2013\*\* Të dhëna paraprake


Tab.4 Produkti i Brendshëm Bruto sipas metodës së Shpenzimeve, me çmime korrente

Treguesit e PBB-së	Vlera		Indeksi i rritjes nominale (%)	Struktura e PBB (%)	
	Në Million Lek			2012*	2013**
	2012*	2013**	(2013/2012)	2012*	2013**
<b>Konsumi Final</b>	1.181.940	1.219.326	3,16	88,50	89,34
<b>Konsumi Final i Popullatës</b>	1.034.611	1.068.822	3,31	77,47	78,31
<b>Konsumi Final i Administratës Publike</b>	145.154	148.227	2,12	10,87	10,86
Konsumi Individual	70.698	73.416	3,84	5,29	5,38
Konsumi Kolektiv	74.456	74.810	0,48	5,58	5,48
<b>Konsumi i Institucioneve Jo-fitimprurëse</b>	2.175	2.277	4,72	0,16	0,17
<b>Formimi Bruto i Kapitalit Fiks</b>	345.031	353.878	2,56	25,84	25,93
<b>Ndryshimet e gjëndjeve</b>	36.964	35.103		2,77	2,57
<b>Mospërputhje statistikore</b>	19.926			1,49	
<b>Eksporti neto</b>	-248.372	-243.525	-1,95	-18,60	-17,84
<b>Eksportet e mallrave e shërbimeve (fob)</b>	444.514	478.759	7,70	33,28	35,08
Eksportet e mallrave	212.132	246.391	16,15	15,88	18,05
Eksportet e shërbimeve	232.382	232.368	-0,01	17,40	17,03
<b>Importet e mallrave e shërbimeve (fob)</b>	692.887	722.284	4,24	-51,88	-52,92
Importet e mallrave	490.029	487.641	-0,49	36,69	35,73
Importet e shërbimeve	202.858	234.643	15,67	15,19	17,19
<b>PRODHIM I BRËNDSHËM BRUTO</b>	1.335.488	1.364.782	2,19	100,00	100,00

2012\* Të dhëna gjysëm-finale

2013\*\* Të dhëna paraprake

Fig 2. Struktura e PBB me metodën e Shpenzimeve, në %



**Tab.5 Produkti i Brendshëm Bruto sipas metodës së Shpenzimeve me çmime konstante**

Treguesit e PBB-së	Vlera		PBB me çmime të vitit të mëparshëm	Rritja reale (%)
	Në Million Lek			
	2012*	2013**	(2013/2012)	2013**
<b>Konsumi Final</b>	1.181.940	1.219.326	1.204.918	1,94
<b>Konsumi Final i Popullatës</b>	1.034.611	1.068.822	1.053.310	1,81
<b>Konsumi Final i Administratës Publike</b>	145.154	148.227	149.314	2,87
Konsumi Individual	70.698	73.416	73.825	4,42
Konsumi Kolektiv	74.456	74.810	75.489	1,39
<b>Konsumi i Institucioneve Jo-fitimprurëse</b>	2.175	2.277	2.294	5,47
<b>Formimi Bruto i Kapitalit Fiks</b>	345.031	353.878	349.021	1,16
<b>Ndryshimet e gjëndjeve</b>	36.964	35.103	48.047	
<b>Mospërputhje statistikore</b>	19.926			
<b>Eksporti neto</b>	-248.372	-243.525	-247.899	-0,19
<b>Eksportet e mallrave e shërbimeve (fob)</b>	444.514	478.759	479.581	7,89
Eksportet e mallrave	212.132	246.391	246.186	16,05
Eksportet e shërbimeve	232.382	232.368	233.395	0,44
<b>Importet e mallrave e shërbimeve (fob)</b>	692.887	722.284	727.479	4,99
Importet e mallrave	490.029	487.641	496.826	1,39
Importet e shërbimeve	202.858	234.643	230.654	13,70
<b>PRODHIM I BRËNDSHËM BRUTO</b>	<b>1.335.488</b>	<b>1.364.782</b>	<b>1.354.087</b>	<b>1,39</b>

2012\* Të dhëna gjysëm-finale

2013\*\* Të dhëna paraprake

# Informacion për përdoruesin

Llogaritë Kombëtare Vjetore janë të harmonizuara me konceptet dhe metodologjitë e Sistemit Evropian të Llogarive 2010 dhe 1995 (ESA 2010 dhe ESA 1995).

Vlerësimet e PBB vjetore 2013 në këtë publikim janë të bazuara në burime statistikore me të dhëna vjetore, si Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve (ASN) dhe burime administrative si Pasqyrat Financiare Vjetore të njësisë ekonomike, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare dhe Statistika të Qeverisë etj.

Vlerësimet e PBB 2013 janë kryer sipas metodës së prodhimit dhe shpenzimeve.

Të dhënat e Llogarive Kombëtare aktualisht janë përpiluar në nivelin e 26 aktiviteteve, duke përdorur Klasifikimin Evropian të Aktiviteteve Ekonomike (Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike – shkurt NVE Rev.1.1 ose NACE rev1-termi Angl). Në publikimin e ardhshëm të vlerësimeve vjetore do të publikohen sipas Nomenklaturës së Veprimtarisë Ekonomike Rev.2<sup>1</sup>.

## Politikat revizionuese

Të dhënat e publikuara revizionohen mbështetur në politikat revizionuese të llogarive kombëtare. Vlerësimet vjetore të Produktit të Brendshëm bruto (PBB) dhe komponentëve të tij janë subjekt i dy tipeve të revizionimit: të zakonshme dhe rastësore.

Revizionime të zakonshme: Revizionimet e zakonshme të të dhënave vjetore kryhen që nga vlerësimet e para me baza tremujore të PBB-së. Vlerësimi paraprak me baza vjetore mbështetet në të dhënat paraprake nga anketat dhe në disa raste në burime të tjera administrative. Aktualisht, periudha e kalimit para publikimit të vlerësimit të parë vjetor të PBB (paraprake/flash) (viti t) është njëmbëdhjetë muaj (në fillim të Dhjetorit të vitit t+1). Një vlerësim i tillë rishikohet pas gjashtë muajsh në mënyrë që të marrim një vlerësim gjysëm-final. Në këtë moment rishikohen gjithashtu edhe vlerësimet e vitit të kaluar (t-1).

Revizionimet të veçanta: Revizionimet e veçanta lidhen me risite kryesore metodologjike, të cilat mund të jenë rrjedhojë e ndryshimeve në koncepte, metoda dhe klasifikime të përdorura ose të disponueshmërisë apo përmbajtjes së burimeve statistikore.

---

<sup>1</sup> Për më shumë informacion referohuni link-ut: <http://www.instat.gov.al/publications/njoftim-per-media/njoftim-per-media-ndryshimi-i-nomenklaturës-së-veprimtarive-ekonomike.aspx>

### Përkufizime

**Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB):** Prodhimi i brendshëm bruto, vlerësuar me çmimet e tregut, është rezultati final i aktivitetit të prodhimit nga njësitë rezidente prodhuese gjatë një viti. Ai është llogaritur sipas dy mënyrave:

- **PBB me mënyrën e prodhimit,** është i barabartë me shumën e vlerave të shtuara bruto sipas degëve të ndryshme të aktiviteteve, duke shtuar tatimet e taksat e duke i zbritur subvencionet mbi produktet (të cilat nuk u janë shpërndarë sektoreve apo degëve të aktivitetit);

- **PBB sipas mënyrës së shpenzimeve** është i barabartë me përdorimet finale të brendshme të produkteve e shërbimeve (konsumi final efektiv, formimi bruto i kapitalit fiks, ndryshimet e gjendjeve), plus eksportet, minus importet.

**Vlera e shtuar bruto:** Vlera e shtuar bruto përfaqëson kontributin e aktiviteteve të ndryshme në PBB dhe llogaritet si diferencë midis prodhimit dhe konsumit të ndërmjetëm.

**Çmimet e tregut:** janë çmimet pasi shtohen taksat mbi produktet minus subvencionet mbi produktet.

**Taksat mbi produktet dhe importin:** Taksat mbi produkte janë taksat e pagueshme për njësi të disa mallrave dhe shërbimeve si Taksa mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), akciza, taksa dhe taksa doganore mbi importet.

**Subvencione në produkte:** Subvencionet në produkte janë pagesat e pakthyeshme që njësitë e administratës publike bëjnë tek ndërmarrjet si një shumë e caktuar parash për njësi të një malli ose shërbimi. Subvencionet në importe konsistojnë në subvencionimin e mallrave ose shërbimeve që bëhen të pagueshme kur malli kapërcen kufirin e territorit ekonomik ose kur shërbimet i janë kaluar njësisive institucionale rezidente.

**Konsumi Final:** Konsumi Final është një nga komponentët kryesorë të PBB. Ky konsiston në mallrat dhe shërbimet e përdorura nga familjet individuale ose komunitetet dhe llogaritet si shumë e konsumit final të familjeve, konsumit final të administratës publike dhe konsumit final të Institucioneve Jo Fitimprurëse që i Shërbejnë Familjeve (IJFPSf).

**Konsumi final i familjeve:** Llogarit të gjitha mallrat dhe shërbimet që përdoren direkt për të plotësuar kërkesat individuale të familjeve rezidente.

**Konsumi final i administratës publike dhe Institucioneve jo fitim prurëse:** Përmban vlerën e shërbimeve jotregtare të kryera nga administrata publike dhe nga institucionet jofitimprurëse në përfitim të komuniteteve ose grupe familjesh. Kjo llogaritet si diferencë midis prodhimit të administratës publike dhe NPISHs dhe vlerës së prodhimit tregtar.



**Eksporti neto:** Eksporti neto llogaritet si diferencë midis eksportit të mallrave dhe shërbimeve (f.o.b) dhe importit të mallrave dhe shërbimeve (f.o.b).

**Formimi Bruto i Kapitalit Fiks:** Konsiston në shpenzimet e kryera për kapitale të reja ose për shpenzime të tjera specifike kryer nga prodhuesit në sende ose shërbime me qëllim që të mbajnë, rritin ose zgjerojnë kapacitetin e tyre prodhues ose që të krijojnë kushte të reja përpunimi në të ardhmen.

**Ndryshimi i gjendjeve:** Përcaktohet si diferencë midis gjendjeve të inventarit dhe në proces të aktiveve qarkulluese në fund dhe në fillim të vitit. Gjendjet përfshijnë: materiale të para dhe materiale të tjera; prodhime, punime shërbime në proces; produkte të gatshme e gjysëm të gatshme, mallra, kafshë, etj.

**Çmime konstante:** çmimet korente të deflatuara me indeksin e çmimit të vitit të mëparshëm.

**Çmime korente:** çmimet e periudhës referuese.